



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, merr;

### VENDIM

#### PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

##### Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 19,750.00€, ndihmë për njëqindën të (109) personave me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

##### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

##### Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

##### Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

##### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-400/01-0002433/24  
Podujevë, datë: 09.01.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe duke u mbështetur në Marrëveshjen nr.prot.02-016/01-002673/24 të lidhur mes Kryetarit të Komunës së Podujevës dhe Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**z.Bashkim Ibrahim**, zyrtar i lartë i prokurimit në Komunën e Podujevës (i transferuar sipas Marrëveshjes së lartcekur), **autorizohet** për kryerjen punëve dhe detyrave si dhe nënshkrimin e dokumentacionit nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Prokurimit në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së cekur për shkak të mungesës së Menaxherit të Prokurimit i cili është pensionuar, dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur komform rregullativës ligjore në fuqi, apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_  
*Bj*

#### Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Administratës - DA dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/05-0058743/23 datë 11.08.2023.

Me këtë vendim njoftohen:  
I Autorizuari  
DA dhe Zyra e Personelit  
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-020/05-0003169/29  
Podujevë, datë: 11.01.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, nenit 16 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

Shfuqizohet Vendimi me nr.prot.02-016/01-0035379/19 i datës 26.04.2019, sipas të cilit Arsim Mehmeti, ish udhëheqës i sektorit të Kadastrit në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPGJ-Komuna e Podujevës, ka qenë i caktuar zyrtar përgjegjës për sinjalizim në kuadër të administratës të Komunës së Podujevës.

#### Neni 2

Shfuqizimi i vendimit të cekur sipas nenit 1, bëhet për arsye të shkuarjes së zyrtarit të cekur në punë dhe detyra tjera të punës në një institucion tjetër në Republikën e Kosovës.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*


*Zyrës së Personelit*

*QSHQ/Arkivit*

*Për njoftim Arsim Mehmeti, përmes zyrës së personelit*

Nr.Prot. 02-016/01-0004184/24  
Podujevë, datë: 15.01.2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 17 dhe 30.2 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neneve 16, dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të komunës së Podujevës nr.pro.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.208, merr;

### VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM

#### Neni 1

Zyrtar përgjegjës për sinjalizim në kuadër të Komunës së Podujevës, caktohet:

**z. Blerim Nishefci**, zyrtar i lartë i personelit, në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës

E-mail; [blerim.nishevci@rks-gov.net](mailto:blerim.nishevci@rks-gov.net)

Voip: 038 200 41-015

Tel mob.: 049/114-493

#### Neni 2

Zyrtari përgjegjës detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe akteve tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore që i referohen fushëveprimit nga funksioni që ushtron.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

*U dërgohet:*

*Të caktuarit*

*Agjencisë Kundër Korrupsionit*

*Zyrës së Personelit*

*QSHQ /Arkivës*

Nr.Prot. 02-020/05-0004187/24

Podujevë, datë: 15.07.2024





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenet 13, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 8485, datë 28.12.2023, të lidhur në mes Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Podujevës, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ngritet Komisioni për përcjelljen e procesit të transferit të stafit të sektorit të pylltarisë, dokumentacionit përkatës, automjetet dhe pajisjet tjera si dhe mjetet tjera funksionale, në këtë përbërje:

**Fitim Bunjaku**, kryesues - Zyra e Personelit

**Ymer Hoti**, anëtar - Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Osman Bajrami**, anëtar - Zyra Ligjore

#### **Neni 2**

Komisioni ka për obligim të bëjë përcjelljen e procesit të transferit të stafit të sektorit të pylltarisë, dokumentacionit përkatës (Listë të stafit që transferohet me të dhënat përkatëse, dosjeve personale fizike dhe elektronike) të rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë dhe përgjegjëseve të sektorit, automjeteve dhe pajisjeve tjera si dhe mjeteve tjera përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme të sektorit pyjor.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Anëtarëve të Komisionit  
Zyrës së Personelit  
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0004879/24  
Podujevë, datë: 16-01-2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Balliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafët 1.13 dhe 1.15 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.09-615/03-0004394/24 të datës 15.01.2024, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Rrahman Fazliu**, nga fshati Llaushë Komuna e Podujevës, për realizimin e akademisë përkujtimore të atdhetarit ish Kryetarit të parë të Komunës së Podujevës "Shaqir (Halil) Visoka – Hoxhë Visoka", mbështetet me mjete financiare në shumë 300.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Rrahman Fazliu (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/04-0005301/24  
Podujevë, datë, 18.07.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0006141/24, të datës 22.01.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Muhamet Çitaku** nga fshati Bajçinë Komuna e Podujevës i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€, për mbulimin e shpenzimeve për trajtim të mëtutjeshëm mjekësor të prindit të tij z.Shemsi Çitaku, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të z.Muhamet Çitaku.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave- DBF*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Muhamet Çitaku (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/04-000 6340/24  
Podujevë, datë, 23.01.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores nr.04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS), nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit "Avdush Hasani"- Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, dhe nenin 2 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës "Avdush Hasani" nr.prot.01-640/01-0051835/21 të datës 28.06.202, merr;

### V E N D I M

#### Neni 1

Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0020237/22 i datës 18 mars 2022 për Emërimin e Këshilli Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0024655/22 të datës 04 prill 2022, përkatësisht përbërja e anëtarëve të emëruar, dhe atë:

**znj.Rita Haxhiu** nga Podujeva, emërohet anëtare në kuadër të Këshillit Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani", në vend të znj.Doruntina Hasani, e cila ka ofruar dorëheqje për shkaqe personale.

#### Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e Vendimit numër prot.02-020/04-0020237/22, të datës 18 mars 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0024655/22 të datës 04 prill 2022.

*Me këtë njoftohen:*

*E emëruara*


*Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS*

*Anëtarët e Këshillit (përmes DKRS)*

*Teatri i Qytetit*

*QSHQ / Arkivi*

Nr.prot.02-020/04-0006549/24  
Podujevë, datë: 24.01.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 02-400/04-0006562/24, të datës 24.01.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z.Gzim Fejzullahu**, nga Podujeva, për shkak të gjendjes të rënduara ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 5000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të të përmendurit.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Gzim Fejzullahu (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/04-0006716/24  
Podujevë, datë, 24.01.2023



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT PËR BARAZI GJINORE

#### Neni 1

Ngritet grupi punues për hartimin e Planit për Barazi Gjinore në Komunën e Podujevës, si në vijim:

**Marigona Lahu**- Nënkyetare e Komunës  
**Hilmi Hoxha**- Kryesues i Kuvendit  
**Edona Çitaku** – Shefe e Kabinetit të Kryetarit  
**Adelina Stublla** – Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale  
**Ejup Babatinca** – Udhëheqës i sektorit të Zhvillimit Ekonomik  
**Sabedin Namani** – Udhëheqës i Zyrës Ligjore  
**Kadrie Ajvazi** – Udhëheqëse e sektorit të Buxhetit dhe Financave  
**Fitim Bunjaku** – Udhëheqës i Burimeve Njerëzore  
**Halit Vërshevc** – Udhëheqës i sektorit të Shëndetësisë  
**Naime Podvorica** – Zyrtare për Barazi Gjinore  
**Mimoza Restelica** – Zyrtare Kryesore Financiare  
**Flaka Ajeti** – Asistente e Kuvendit Komunal

#### Neni 2

Detyrë e grupit punues është hartimi i Planit për Barazi Gjinore në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.

#### Neni 3

Grupi punues për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Anëtarëve të grupit punues*

*QSHQ/Arkivit*

Nr.prot 02-020/04-0006768/24  
Podujevë, datë, 24.07.2024



Kryetari i Komunës  
Shqipëri Bulliqi



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, udhëzuesin nr. 20/2018 për ndalimin e telefonave celular në institucionet arsimore para universitare dhe neneve 16 dhe 61 para. 1.7 të Statutit të komunës së Podujevës nr.pro.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2008, merr;

### V E N D I M

#### Neni 1

Ndalohet posedimi i telefonit gjatë procesit mësimor nga nxënësit, mësimdhënësit dhe stafi profesional dhe punëtorët tjerë në mjediset – ambientet e institucioneve edukative-arsimore para universitare në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Obligohen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtorët e institucioneve të arsimit para universitar për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me Udhëzuesin nr. 20/2018 dhe janë përgjegjës për marrjen e masave sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 3

Vendimi në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon së zbatuari nga data 01.02.2024.

*U dërgohet:*

*DKA-së*

*Drejtorëve të shkollave( përmes DKA-së)*

**Nr.Prot.** 02-016/01-0006758/24  
**Podujevë, datë:** 24. 01. 2024



**Kryetari i Komunës**  
**Shpetim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot.02-118/02-0006839/24, datë 25.01.2024 për lirim nga detyra e U.D të zëvendës drejtoreshës së SHFMU “Shaban Shala”, merr;

### V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT Nr.Prot. 02-020/05-0039237/23 TË DATËS 07.06.2023**

#### Neni 1

Shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/05-0039237/23 i datës 07 qershor 2023, përkatësisht **znj.Aisela Uka**, me vendbanim në Podujevë, lirohet nga pozita e emërimit të përkohshëm zëvendës drejtoreshë në SHFMU “Shaban Shala” - Podujevë.

#### Neni 2

Lirimi nga detyra sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet duke i'u referuar propozimit të Drejtorit të DKA në Podujevës sipas të cilit e përmendura nuk është paraqitur për një kohë në vendin e punës duke mos ofruar arsyeshmëri të mjaftueshme për mungesën në punë.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

Drejtorisë së Arsimit  
znj.Aisela Uka (përmes DKA)  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0006897/24  
Podujevë, datë: 25.01.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit datë 30.01.2024 sipas kërkesës nr. prot.05-110/03-0007536/24, datë 29.01.2024 për lirim nga pozita e drejtoreshës së SHFMU “Ilir Kunushevci” në fshatin Llugë, Komuna e Podujevës, merr;

### V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT Nr.Prot. 02-020/02-0043978/22 TË DATËS 10.06.2023**

#### Neni 1

Shfuqizohet vendimi 02-020/02-0043978/22, datë 10.06.2023, përkatësisht **znj.Lirie Sejdiu**, me vendbanim në Podujevë, lirohet nga pozita e drejtoreshës në SHFMU “Ilir Kunushevci” – fshati Llugë, Komuna e Podujevës.

#### Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi lirohet nga pozita e cekur sipas kërkesës së saj për shkak të angazhimeve personale dhe familjare.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Drejtorisë së Arsimit  
znj.Lirie Sejdiu (përmes DKA)  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0008093124  
Podujevë, datë: 31.01.2024



Kryetari i Komunës  
Shejtim Bulliqi



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-110/05-0007723/24 datë 29.01.2024, nxjerrë këtë;

### VENDIM

### PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "ILIR KONUSHEFCI" NË FSHATIN LLUGË KOMUNA E PODUJEVËS

#### Neni 1

**Z Blerim Zhitia**, me nr. personal të letërnjoftimit 1113, me vendbanim në fshatin Llugë, Komuna e Podujevës, i kualifikuar Fakulteti Filologjik, drejtimi Letërsi dhe Gjuhë Shqipe,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHFMU "Ilir Konushefci" në fshatin Llugë, Komuna e Podujevës.

#### Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:  
Drejtorisë së Arsimit  
Të emëruarit  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0009139/24  
Podujevë, datë: 31.01.2024



Kryetari i Komunës  
Shpëjtim Bulliqi